



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 25, datë 28.03.2024

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“ATLANTIK – SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike të shoqërisë “Atlantik– Shoqëri Sigurimesh” sh.a., siç paraqiten në 31 dhjetor 2023, sipas përlogaritjes së shoqërisë.
2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2023 të provigjoneve teknike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:

Provigjonet teknike në 31 dhjetor 2023	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	1,108,995,249
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	<i>11,080,031</i>
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	1,097,915,218

3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

NËNDREJTOR EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI